

Në përputhje me kërkesat nga neni 33 i Ligjit Nr.02/L-016, për shoqëritë tregtare në Kosovë,
Themeluesit e Shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar më dt. 25.09.2020 nxjerr:

STATUTIN

E

“FRUTEX” SH.P.K.

Shirokë- Suharekë Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar

Neni 1

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Me këtë Statut rregullohen këto çështje :

- emërtimi i Shoqërisë,
- lloji i shoqërisë,
- adresa e selisë së saj,
- periudha e kohëzgjatjes,
- veprimtaria e shoqërisë,
- llojet e aksioneve të autorizuara për emetim, vlerën e tyre nominale, numrin dhe të drejtat e bartësve të tyre,
- organet drejtuese,
- emrat dhe adresat e themeluesve dhe
- procedurat me të cilat mund të ndryshohen rregulloret.
-

Neni 2

EMËRTIMI I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR

Emërtimi i plotë i shoqërisë është : Shoqëria Tregtare ”FRUTEX” SH.P.K shoqëri me përgjegjësi të kufizuar.

Shkurtimisht : “FRUTEX” SH.P.K

Neni 3
LLOJI I SHOQËRISË

Shoqëria Tregtare është Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, shkurtimisht **SH.P.K.**

Neni 4
ADRESA E SELISË

4.1. Selia e "FRUTEX"SH.P.K. është në Shirokë Zona Industriale, Suharekë

4.2. Personi i autorizuar i kësaj shoqërie tregtare është Shaqir Palushi, i cili është person i ligjshëm për pranimin e shërbimeve, njoftimeve, kërkesave si dhe akteve tjera që dërgohen nga autoritetet publike.

4.3 Shoqëria mund të themeloj filiale, zyra përfaqësimi brenda vendit në pajtim me legjislacionin në fuqi.

4.4 Frutex, organizohet në disa njësi e këto janë:

- Njësia Nr. 1, me adresë, fshati Gelancë, komuna e Suharekës
- Njësia Nr. 2, Hotel Prishtina me adresë, Rr. Pashko Vasa, Prishtinë
- Njësia Nr. 3, N.P Frutex-3, me adresë, Rr. Zahir Pajaziti, Prizren
- Njësia Nr. 4, N.P Frutex-4, me adresë, Rr. Lekë Dukagjini, Prizren
- Njësia Nr. 5, me adresë, Fshati Novakë,
- Njësia Nr. 6, me adresë, Rr. Ukë Bytyqi, Shirokë, Zona Industriale p.n, Suharekë.

Neni 5
QËLLIMI I THEMELIMIT TË SHOQËRISË

Qëllimi i themelimit të Shoqërisë është qëllim i ligjshëm afarist, si dhe përfitimi personal dhe ndihma vendit ku jetojnë me kontribute dhe taksa të ndryshme.

Neni 6
PERIUDHA E KOHËZGJATJES SË SHOQËRISË

Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë si sh.p.k. do të jetë në afat të pacaktuar.

Neni 7
VEPRIMTARIA E SHOQËRISË

Veprimtaria e Shoqërisë është :

Te gjitha veprimtaritë e Shoqërisë regjistrohen tek Zyra regjistrimit e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë

- 0111** - Kultivimi i drithërave (përveç orizit), i bimëve bishtajore dhe i farërave vajore
- 0113** - Kultivimi i perimeve, pjepërave dhe shalqirit, bimëve rrënjore dhe tuberoze
- 0125** - Kultivimi i frutave të tjera pemore, shkurreve dhe arrive
- 0150** - Fermat e përziera
- 0210** - Kulturat pyjore dhe aktivitetet e tjera të pylltarisë
- 1032** - Përpunimi i lëngut të frutave dhe perimeve
- 1039** - Përpunimi dhe konservimi tjetër i frutave dhe perimeve
- 1051** - Prodhimi i produkteve të qumështit
- 1061** - Përpunimi i produkteve të drithërave
- 1104** - Prodhimi i pijeve të tjera të fermentuara të padistiluara
- 1105** - Prodhimi i birrës
- 1107** - Prodhim i pijeve freskuese; prodhimi i ujit mineral dhe ujit tjetër në shishe.
- 2222** - Prodhimi i artikujve të plastikës për paketim
- 4120** - Ndërtimi i objekteve banesore dhe jobanesore
- 4612** - Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e karburantit, mineraleve, metaleve dhe kimika teve industrial
- 4621** - Tregtia me shumicë e drithërave, duhanit të papërpunuar, farërave dhe ushqimit të kafshëve
- 4622** - Tregtia me shumicë e luleve dhe bimëve
- 4631** - Tregtia me shumicë e frutave dhe perimeve
- 4634** - Tregtia me shumicë e pijeve
- 4635** - Tregtia me shumicë e produkteve të duhanit
- 4639** - Tregtia me shumicë, jo e specializuar, e artikujve ushqimorë, pijeve dhe duhanit
- 4671** - Tregtia me shumicë e lëndëve djegëse të ngurta, të lëngëta ose të gazta dhe produkteve të lidhur me to
- 4690** - Tregtia me shumicë jo e specializuar
- 4711** - Tregtia me pakicë në dyqane jo të specializuar, ku mbizotëron ushqimi, pijet dhe duhani
- 4725** - Tregtia me pakicë e pijeve në dyqane të specializuara
- 4751** - Tregtia me pakicë e tekstileve në dyqane të specializuara
- 4771** - Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara
- 4941** - Transporti rrugor i mallrave
- 5210** - Magazinimi dhe ruajtja
- 5229** - Aktivitetet e tjera mbështetëse të transportit
- 5510** - Hotelet dhe akomodimi i ngjashëm
- 5610** - Restorantet dhe aktivitetet shërbyese lëvizëse të ushqimit
- 6820** - Qiradhënia dhe menaxhimi i patundshmërisë personale ose të marra me qira
- 7112** - Aktivitetet e inxhinierisë dhe këshillimit teknik
- 8292** - Aktivitetet e paketimit (ambalazhimit)

NENI 8

KAPITALI THEMELOR

8.1 Kapitali themelor i ndërmarrjes është 4,656,734.00 €. Është i ndarë në aksione nominativë me vlerën minimale 00 €.

NENI 9

NDRYSHIM I KAPITALIT THEMELOR

9.1 Kapitali themelor mund te ndryshohet me te gjitha mënyrat dhe modalitetet e kërkuara nga legjislacioni ne fuqi.

9.2 Organi kompetent për të vendosur për ndryshimin e kapitalit themelor është Asamble a aksionareve e cila merr vendime në bazë të raportit të Drejtorit që përmban treguesit e kërkuar nga ligji.

9.3 Në rastin e zmadhimit të kapitalit themelor me para në dore, Aksionaret e shoqërisë kane një të drejte parësore në nënshkrimin e tij, proporcionalisht me shumën e aksioneve që ata zotërojnë dhe me përqindje që ju përket në kapitalin e ndërmarrjes .

9.4 Zmadhimi i kapitalit nëpërmes rritjes nominale të saksonëve behet vetëm me pëlqime unanime të aksioneve me përjashtim të rastit kur ai realizohet me përfshirjen e rezervave të fitimeve apo premive të emetimit.

9.5 Ata mund të heqin dorë nga kjo e drejtë, vetëm shkrim në mbledhjen e aksioneve ku miratohet ky zmadhim.

Neni 10

THEMELUESIT E SHOQËRISË

10.1. Themeluesit e shoqërisë mund të jenë persona fizik ose juridik, që kanë ven ose do të kenë në zotërim aksione te shoqërisë, me te gjitha mënyrat e parashikuara me ligj.

10.2. Themelues:

1. Shaqir Palushi me numër personal 1002561484

Themelues	Adresa	Kapitali	Aksionet	Vlera nominale
Shaqir Palushi	Novak p.n	4,656,734.00	46567.34	100.00
	Gjithsejte:	4,656,734.00	46567.34	100.00

Neni 11

TË DREJTAT DHE DETYRAT E THEMELUESVE

11.1. Interesat pronësore që mund të quhen “aksion” në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar janë njësitë në bazë të cilave bëhet ndarja e pronësisë në shoqëri.

11.2. Një interes pronësor në shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar është pronë personale e pronarit dhe mund të bartet pjesërisht ose në tersi, varësisht nga kufizimet e parapara në këtë Statut dhe kufizimet e tjera të përcaktuara në Marrëveshjen e shoqërisë.

11.3. Themeluesit e shoqërisë janë përgjegjës për të gjitha borxhet e shoqërisë dhe detyrimet e tjera me të tëra asetet.

11.4. Të gjithë themeluesit apo ndonjëri prej tyre që ndërmarrin veprim në emër të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar duke bërë hapjen e xhirollogarive bankare, blerjen dhe dhënien me qira të pronës, lidhjen e kontratave ose ndërmarrjen e detyrimeve tjera, janë bashkërisht dhe personalisht përgjegjës për pretendimet dhe detyrimet që lindin si rezultat i këtyre veprimeve.

11.5. Çdo aksionar, ka të drejtën e pjesëmarrjes në fitimet e shpërndahem të shoqërisë dhe përfiton proporcionalisht me shumën e aksioneve që zotëron.

11.6. Çdo vonesë në derdhjen e shumave të duhura nga shumat e pashlyera të aksioneve sjell pagimin e interesave, me përqindjet ligjore dhe kjo pavarësisht nga veprimet personale që shoqëria mund të ushtroj ndaj aksionarit që nuk ka shlyer detyrimin dhe nga masat e zbatimit të detyruar të parashikuara nga legjislacioni në fuqi.

Neni 12

ORGANET DREJTUESE TË SHOQËRISË

12.1 Organet drejtuese të shoqërisë janë:

1. Kuvendi i aksionareve
2. Drejtori apo Drejtorët Menaxhues.

Shoqëria mund të krijoj dhe mbajë edhe një Bord të drejtorëve.

Neni 13

Kuvendi i aksionarëve

13.1. Kuvendi i aksionarëve, qoftë i zakonshëm apo i jashtëzakonshëm ka kompetenca dhe merr të gjitha vendimet e përcaktuara me Ligjin për shoqëritë tregtare ose Statut.

13.2. Kuvendi i aksionarëve do të mbahet në zyrën e regjistruar të shoqërisë ose në një vend tjetër të caktuar më parë me paralajmërimin për mbledhje.

Neni 14

E drejta e votës

14.1. E drejta e votës rrjedh nga zotërimi i aksioneve që përfaqësojnë dhe çdo aksion të jep të drejtën e të paktës një (1) vote.

14.2. E drejta e votës që rrjedh nga përfaqësimi, kërkon një mandat përfaqësimi të shkruar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Neni 15
Drejtimi i mbledhjeve të Kuvendit

15.1. Thirrja e mbledhjes së Kuvendit bëhet :

- nëpërmes njoftimit të dërguar me letër rekomande në adresën e çdo aksionari me shpenzimet e shoqërisë apo

- në mënyrë elektronike në email adresat e aksionareve ku patjetër duhet konfirmimi.

15.2. Mbledhjet e Kuvendit të aksionarëve drejtohen nga një Kryesues i caktuar nga Kuvendi.

15.3. Gjithashtu mbledhjen e Kuvendit mund ta drejtojnë personat që kanë autorizim e në pajtueshmëri me Ligjin për Shoqëritë Tregtare.

15.4. Kryesuesi cakton një procesmbajtës për të mbajtur procesverbalin lidhur me pikat e rendit të ditës.

Neni 16
Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit

16.1. Procesverbalet e mbledhjes së Kuvendit, duhet të mbahen në përputhje me kërkesat e Ligjit për shoqëritë tregtare dhe detyrimisht në fund të saj ,duhet të nënshkruhen nga Kryesuesi dhe procesmbajtësi.

16.2. Kuvendi i jashtëzakonshëm mund të marrë vendime të vlefshme vetëm në rast se aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë në mbledhjen e parë të paktën $\frac{1}{2}$ e aksioneve dhe në të dytën $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në mungesë të këtij kuorumi mbledhja e dytë e Kuvendit mund të shtyhet për një datë të mëvonshme jo më të largët se dy muaj nga data e thirrjes së parë. Ajo merr vendim me një shumicë votash prej $\frac{3}{4}$ që u përkasin aksionarëve të pranishëm ose të përfaqësuar.

16.3. Kuvendi i zakonshëm merr vendime të vlefshme në mbledhjen e parë, vetëm nëse aksionarët e pranishëm ose të përfaqësuar zotërojnë $\frac{1}{4}$ e aksioneve me të drejtë vote. Në raste se kjo mbledhje nuk realizohet, në të dytën nuk kërkohet asnjë lloj kuorumi.

16.4. Kuvendi i zakonshëm merr vendim me shumicën e votave që zotërojnë aksionerët e pranishëm ose të përfaqësuar.

Neni 17
E drejta për të u njohur me dokumente

17.1 Drejtori duhet të paktën 8 ditë para ditës së caktimit të mbledhjes së Kuvendit të iu dërgojë dokumentet e nevojshme aksionarëve për tu njohur dhe për të dhënë një gjykim të plotë, mbi administrimin dhe ecurinë e punëve të shoqërisë në fund të vitit, raportet mbi aktivitetin e shoqërisë, raportin e ekspertit të kontabilitetit, raportin e këshillit mbikëqyrës, të gjitha projekt

vendimet dhe konkluzionet si dhe të gjitha dokumentet tjera të parapara me” Ligjin për Shoqëritë Tregtare”.

Neni 18 ***Nëpunësit e shoqërisë***

18.1. Nëpunësit e Shoqërisë zgjedhën nga Drejtori. Shoqëria nuk mund të ketë më pakë se dy nëpunës.

18.2. Kompetencat e nëpunësve parashihen me aktet normative të Shoqërisë si dhe në marrëveshje me Drejtorin sipas dispozitave të Ligjit për Shoqëritë Tregtare dhe ligjeve tjera relevante

Neni 19 ***Drejtori***

19.1. **Drejtor i Shoqërisë** emërohet Shaqir Palushi, me adresë Novakë, Prizren i cili do të ushtroi funksionet e tij/saj nën kontrollin e Kuvendit të aksionarëve.

19.2. Drejtori mund të shkarkohet për shkaqe të cenimit të ligjit nga Kuvendi i aksionarëve. Si shkaqe të cenimit të ligjit konsiderohen veçanërisht një faj i rëndë i Drejtorit, pa aftësia e tij në kryerjen korrekte të funksioneve ose kur Kuvendi humb besimin tek ai.

Neni 20 ***Kompetencat dhe kufizimet***

20.1 Drejtori ka këto kompetenca:

- të paraqitet, përfaqëson dhe nënshkruan për shoqërinë,
- të ekzekutoi Vendimet e Kuvendit,
- të udhëheq afarizmin e shoqërisë,
- të organizon dhe udhëheq me procesin e punës,
- përgatit pasqyrat vjetore të kontabilitetit dhe raportet mbi afarizmin,
- propozon Vendimet të cilat i nxjerr Kuvendi,
- propozon organizimin e brendshëm të shoqërisë,
- i pranon në punë dhe iu shkëput Kontratën e punës punëmarrësve,
- vendos mbi sistemimin e punëmarrësve në vende pune,
- kujdeset për ligjshmërinë e punës në shoqëri,
- vendos mbi procedurat disiplinore të të punësuarve,
- kryen edhe punë të tjera në harmoni me ligjin, Statutin dhe Vendimet e Kuvendit.

20.2. Drejtori si përfaqësues i shoqërisë është i autorizuar të lidhë Kontrata dhe kryej të gjitha veprimet tjera juridike pa kurrfarë kufizimesh.

Neni 21

Veprimet që kërkojnë autorizime paraprake

21.1 Drejtori duhet patjetër të siguroj pëlqimin e kuvendit për rastet në vijim:

- Për lidhjen e punëve juridike siç janë: shtimi, tjetërsimi dhe ngarkimi i patundshmërive dhe mjeteve themelore të cilat gjatë një viti afarist tejkalojnë kundërvlerën prej: (shembull: 00.00 Euro),
- Për investimet dhe pasjet të cilat gjatë një viti afarist të cilat tejkalojnë shumën në kundër vlerë prej: (shembull: 00.00 Euro),
- Marrjen apo dhënien e kredisë në afate më të gjatë se 1 (një) vite, i cili gjatë një viti afaristë tejkalon shumën në kundërvlerë prej: (shembull: 00.00 Euro),
- Për lidhjen dhe shkëputjen e punëve afatgjate obligative me blerës dhe furnitorë, nëse vlera e obligimeve e tejkalon shumën (shembull: 00.00 Euro),
- Në vendosjen e gradacionit për detyrimet e ndryshme për pasurin e paluajtshme të shoqërisë,
- Për dhënien e prokurës.

Neni 22

Përfaqësimi

22.1 Nga ana ligjore ,Shoqëria përfaqësohet nga drejtori.

Neni 23

Ndarja, bashkimi dhe likuidimi i shoqërisë

23.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet, likuidohet ose transformohet në një formë tjetër, përpara afatit të përcaktuar, me vendim të mbledhjes së jashtëzakonshme të aksionarëve, në përputhje me parashikimet e “Ligjit për shoqëritë tregtare”.

Neni 24

Dispozitat përfundimtare

24.1. Ky Statut hyn në fuqi ditën që e aprovojnë Themeluesit e Shoqërisë.

24.2. Ndryshimet dhe plotësimet e këtij Statuti bëhen sipas procedurës së njëjte si është aprovuar.

24.3. Për të gjitha çështjet që nuk janë përcaktuar me këtë Statut do të aplikohen dispozitat e Ligjit për Shoqëritë Tregtare.

Data: 25.09.2020

Vendi: Suhareke

Themeluesit:

1. Shaqir Palushi

